

Përshëndetje z. Matlija,

Ju lutem gjeni me poshtë përgjigjen për kërkesën tuaj:

Banka e Shqipërisë, si autoriteti përgjegjës për licencimin dhe mbikëqyrjen e bankave dhe subjekteve financiare jo banka që ushtrojnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë, mbikëqyr veprimtarinë e tyre brenda kompetencave që i jep ligji për Bankën e Shqipërisë dhe Ligji për Bankat në Republikën e Shqipërisë dhe vlerëson çdo shqetësim të klientëve të tyre vetëm në këtë kuadër.

Së pari, ju informojmë se Banka e Shqipërisë në rregulloret e saj nuk përcakton shërbimet për të cilat subjektet duhet apo nuk duhet të mbajë komision, pasi kjo del përtej kompetencave të Bankës së Shqipërisë. Nëpërmjet rregulloreve, Banka e Shqipërisë kërkon që subjektet të publikojnë dukshëm dhe qartësisht në faqet e tyre të internetit dhe në ambientet e tyre të punës informacionin mbi komisionet për produktet dhe shërbimet që ato ofrojnë për klientët.

Së fundi, dëshirojmë t'iu bëjmë me dije se neni 31 i ligjit Nr. 9662 dt. 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë" i jep pavarësi subjektit në lidhje me administrimin dhe drejtimin.

Ju falënderojmë për vëmendjen!



BANKA E SHQIPËRISË

Adresa: Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë